

**V E N D I M**  
**“PËR VENDOSJEN E SEKUSTROS PREVENTIVE”**

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë e përbërë prej:

**GJYQTARE : ELONA GJOKA**

asistuar nga sekretare gjyqësore Valtida Ribaj, sot më date 24.06.2011, mori në shqyrtim materialin procedues që i përket :

**KËRKUES:** Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, me prokuror Sotir Kllapi

**OBJEKTI:** Caktimin e mases se sigurimit pasuror “sekuestro preventive”

**BAZA LIGJORE:** Neni 274 i K. Pr. Penale.

Gjykata pasi shqyrtoi kërkesën e Prokurorit dhe dokumentacionin e paraqitur

**V Ë R E N:**

Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Tirane ka regjistruar procedimin penal 2722 datë 23 Qershor 2011 për veprën penale të « *Pastrimit të produkteve të veprës penale* » partashikuar nga Neni 287 i K.Penal.

Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit ka dërguar një informacion zyrtar Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tirane, në lidhje me veprimtari financiare të dyshimta të shtetasit A.E, lindur më 20 Gusht 1962, me kombësi turke dhe shtetësi shqiptare, me adresë banimi (.....), Sauk Tiranë.

Nga informacioni rezulton se në datën 15 Qershor 2011, nga ana e autoriteteve Spanjolle është arrestuar shtetasi A.E dhe disa shtetas të tjerë. Arrestimi i tij është bërë në kuader të një hetimi të ndërmarrë nga këto autoritete, për përfshirjen e tij në veprimtari të rryshfetit, pastrimit të parave dhe të korrupsionit në transaksionet tregëtare ndërkombëtare.

Nga informacioni që posedohet nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, rezulton se ky shtetas ka raporte të shumta të transaksioneve të ndryshme bankare me vlera të konsiderueshme monetare.

Në llogaritë e tij në Bankën Credins në datën 18 Shtator 2009, ky shtetas nga depozituar nga Banka Credit Agricol në Zvicër një shumë prej 1 000 000 (një milion) U.S.D.

Në datën 19 Shtator 2009 ka kryer dy transfertat në të njëjtin numër llogarie nga banka Ukios Bank Kaunas Lituani në dy shuma, e para prej 230 955 (dyqind e tridhjetë mijë e nëntëqind pesëdhjetë e pesë) USD me pershkrimin likujdim fature Nr.19648 datë 17 Gusht 2009 për automobil.

Shuma e dytë prej 238 955 (dyqind e tridhjetë e tetë mijë e nëntëqind pesëdhjetë e epesë) USD për likujdim fature Nr.12584 datë 11 Gusht 2009 për automobil.

Ky shtetas ka bërë një sërë pagesash të tjera dhe transfertash bankare në Bankën Kombëtare të Greqisë, dhe dërguesit e parave janë shoqëritë Diron Trade limited, Birmingham, Britani e Madhe. Shtetasi A.E ka përdorur llogaritë e tij personale për të bërë këto transfertat të cilat më pas janë kaluar në llogarinë e shoqërisë “Albania Airlines” sh.p.k.

Ky shtetas ka kryer një sërë transfertash të tjera bankare nga “Notel Assistant” limited në shumën totale, 9 000 000 (nëntë milion) USD, transfertat nga Shoqëria Tandum Limited Qipro në shumën 5.000 000 (pesë milion) USD.

Kjo shumë e fundit është futur në depozitë një javore dhe është rinovuar tre here dhe më pas në SWIFTI, është kërkuar rikthimi i kësaj shume veprim i miratuar nga vetë shtetasi A.E.

Shtetasi A.E është aksioner i vetëm i shoqërisë “Noor Airways” sh.p.k, në llogaritë e të cilës janë transferuar në datën 09 Shkurt 2011 nga Banka International of Azerbaijan dy transfertat në shumat 810.000 (tetëqind e dhjetë mijë) EURO dhe 2 430 000 (dymilion e katërqind e tridhjetë mijë) EURO. Këto transfertat janë bërë me justifikimin e dizbursimit të një kredie të marrë nga Banka “International of Azerbaijan” në favor të shoqërisë Noor Airways sh.p.k.

Nga shumat e mberitura prej 2 324 000 (dymilion e treqind e njëzetë e katër mijë) Euro 1 638 000 (një milion e gjashtëqind e tridhjetë e tetë mijë) Euro janë tërhequr nga Z. A.E dhe ekonomistja dhe një shumë prej 971.000 (nëntëqind e

shtatëdhjetë e një mijë) Euro janë transferuar në favor të shoqërive të tjera “Elite Medica” sh.p.k, “Albanian Elektronik Company” sh.p.k. “Air Mediteranee” dhe A.E.

Nga verifikimet e bëra nga Drejtoria e Pergjithshme e Policise se Shtetit dhe nga Drejtoria e Pergjithshme e Parandalimit te Pastrimit te Parave, rezulton se shtetasi A.E është përfaqësues i disa shoqërive si “Albanian Airlains MAK”, “Albanian Endustrial Company”, “Albanian Elctronic Kompany”, :”Elite Medica”, aksioner i shoqërisë “Noor Airways” ku është aksioner me 100% të kuotave dhe përfaqësues ligjor i saj, “Star Leasing” sh.p.k. ortak me 100% të kapitalit me përfaqësues ligjor A.A.

Për sa më sipër, duke u bazuar edhe në informacionin e ardhur nga Drejtoria e Pergjithshme e Policise se Shtetit, dhe Informacionin e Ardhur nga Drejtoria e Pergjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave, dyshohet se shtetasi A.E ka kryer transferata të dyshimta në llogaritë e tij, dhe nëpërmjet tyre ai dyshohet se kryen veprimtari për pastrimin e produkteve të veprës penale.

Nga verifikimet e bëra nga Drejtoria e Pergjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave, rezulton se shoqëritë e sipërpërmendura dhe vetë shtetasi A.E ka llogari bankare dhe depozita pranë bankave të nivelit të dytë.

Duke qenë se këto shuma parashë, dyshohet se burojnë nga transaksione të dyshimta, si dhe duke qenë se dyshohet se poseduesit e këtyre llogarive, kanë mundësi të veprojnë me këto llogari apo depozita për vazhdimin e transaksioneve të tilla, është e nevojshme të merret masa e sigurimit pasuror e sekuestros preventive ndaj tyre.

Konkretisht nga informacioni i mesiperm rezulton se shtetasi A.E disponon llogari pranë B.K.T në Euro dhe në GBP, pranë Bankës NBG ne EURO, pranë Bankës CREDINS në USD.

Shoqëria Noor Airways sh.p.k posedon llogari pranë BKT ne Euro dhe Leke pranë bankës B.K.T, dhe pranë N.B.G në U.S.D dhe Euro.

Shoqëria Albania Airlines Mak shp.k ka shoqëri pranë B.K.T në monedhe shqiptare Lekë dhe valutë U.S.D dhe Euro., pranë bankës N.B.G në Lekë, Euro, U.SD., dhe G.B.P. kjo shoqëri posedon llogari pranë Itesa San Paolo Bank në Euro, dhe në C.B.A ne Lekë, Euro, U.S.D dhe G.B.P.

Shoqëria Albanian Electronic Company sh.p.k. posedon llogari ne Euro pranë B.K.T dhe pranë bankës N.B.G në U.S.D. dhe Euro.

Shoqëria Elite Medica sh.p.k, zotëron llogari në B.K.T. në Lekë si dhe pranë N.B.G në lekë dhe Euro.

Shoqëria F.G, zotëron llogari pranë N.B.G në Euro.

Shtetasja E.H zotëron llogari pranë B.K.T në lekë, dhe pranë N.B.G bank në lekë.

Për sa më sipër, duke qenë se krijohet dyshimi i arsyeshëm i bazuar në prova se shtetasi A.E është i përfshirë, në transferta të dyshimta parashë, si dhe duke qenë se ai po hetoet dhe nga autoritetet spanjolle dhe ato shqiptare për veprën penale të « Pastrimit të Produkteve të veprës penale » është e nevojshme, vendosja e sekuestros preventive në llogaritë e tij bankare si dhe të shoqrive ku ai është ortak, aksioner apo administrator.

*Neni 274 i K.Pr.Penale parashikon se « Kur ka rrezik që disponimi i lirë i një sendi që lidhet me veprën penale mund të rëndojë ose të zgjasë pasojat e saj ose të lehtësojë kryerjen e veprave penale të tjera, me kërkesën e prokurorit, gjykata kompetente urdhëron sekuestrimin e tijme vendim të arsyetuar. Sekuestroja mund të vendoset edhe për sendet , produktet e veprës penale dhe cdo lloj pasurie tjetër që lejohet të konfiskohet, sipas nenit 36 të K.Penal ».*

Kjo masë sigurimi pasuruar duhet marrë pasi ekzistojnë dyshime se ky person është përfshirë në veprimtari të pastrimit të produkteve të veprës penale, dhe nevojitet me synim ruajtjen e këtyre shumave në gjendjen që janë, duke parandaluar në këtë mënyrë, transferimin e tyre dhe tjetërsimin apo fshehjen, duke shmangur në këtë mënyrë shtimin e pasjave të kësaj vepre penale.

Në këto rrethana Gjykata çmon që kjo kërkesë është e bazuar në ligj dhe si e tillë duhet pranuar.

### **PËR KËTO ARSYE:**

Gjykata në bazë të nenit 274 të K Pr Penale

## V E N D O S I:

- Caktimin e masës së sigurimit pasuror “**Sekuestro Preventive**”, për llogaritë e poshteshnuara pranë bankave;
- Llogaritë bankare të shtetasit A.E ne Euro nr. (.....), dhe G.B.P. nr. (.....), pranë Bankës Kombëtare Tregëtare.
- Llogaritë bankare të shtetasit A.E ne Euro nr. (.....), pranë N.B.G Bank.
- Llogaritë bankare të shtetasit A.E ne U.S.D, me nr. (.....)pranë Credins Bank.
- Llogaritë bankare të shoqërisë Noor Airëays sh.p.k ne Euro nr. (.....) dhe lekë nr. (.....) pranë Bankës kombëtare Tregëtare.B.K.T.
- Llogaritë bankare të shoqërisë Noor Airëays sh.p.k ne Euro nr. (.....)dhe U.S.D. me nr. (.....), pranë N.B.G bank.
- Llogaritë bankare të shoqërisë Albania Airlines Mak sh.p.k ne Euro, nr. (.....) dhe nr. (.....)ne Lekë dhe U.S.D. nr. (.....), pranë Bankës Kombëtare Tregëtare.
- Llogaritë bankare të shoqërisë Albania Airlines Mak sh.p.k ne Euro, nr. (.....), dhe nr. (.....)ne Lekë nr. (.....), G.B.P, nr. (.....)dhe U.S.D., nr. (.....), pranë N.B.G Bank.
- Llogaritë bankare të shoqërisë Albania Airlines Mak sh.p.k ne Euro, me nr. (.....), nr. (.....)dhe(.....), pranë I.S.P. Bank.
- Llogaritë bankare të shoqërisë Albania Airlines Mak sh.p.k ne Euro, me nr. (.....) dhe (.....), ne Lekë, me nr. AL (.....), G.B.P, nr. (.....) dhe U.S.D., me nr. (.....) dhe (.....), pranë C.B.A. Bank.
- Llogaritë bankare të shoqërisë Albania Elektronik Company sh.p.k ne Euro, me nr. (.....), pranë Bankës Kombëtare Tregëtare.
- Llogaritë bankare të shoqërisë Albania Elektronik Company sh.p.k ne Euro, me nr. (.....), dhe U.S.D, me nr. (.....), pranë N.B.G Bank.
- Llogaritë bankare të shoqërisë Elite Medica sh.p.k ne Lekë, me nr. (.....), pranë Bankës Kombëtare Tregëtare.
- Llogaritë bankare të shoqërisë Elite Medica sh.p.k ne Lekë, me nr. (.....) dhe Euro, me nr. (.....), pranë N.B.G Bank.
- Llogaritë Bankare të shtetasit F.G në Euro, me nr. (.....), pranë N.B.G. Bank.
- Llogarite bankare të shtetasës E.H në Lekë, me nr. (.....), pranë Bankës Kombëtare Tregëtare.

- Llogarite bankare të shtetases E.H në Lekë, me nr. (.....), pranë N.B.G. Bank.
- Ngarkohen Drejtorite e Bankave te Nivelit te Dyte Banka Kombetare Tregtare, Intesa Sanpaolo Bank, Credins Bank, NBG Bank, CBA Bank per ekzekutimin e ketij vendimi.
  - Kundër këtij vendimi mund te behet ankim brenda 10 diteve ne Gjykatën e Apelit Tirane, nga data e shpalljes ose nga marrja dijani.
  - U shpall sot, në Tiranë, më 24.06.2011.

**SEKRETARE**

**VALTIDA RIBAJ**

**GJYQTARE**

**ELONA GJOKA**